



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

VENDIM

Nr. 39/2019

**PËR SHQYRTIMIN ME PROCEDURË TË PËRSHPEJTUAR TË PROJEKTLIGJIT
“PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDRYSHUESE TË MARRËVESHJES
PËR BASHKËPUNIMIN TEKNIK NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA
E ZHVILLIMIT URBAN, DHE QEVERISË SË KONFEDERATËS ZVICERANE,
TË PËRFAQËSUAR NGA AGJENCIA ZVICERANE PËR ZHVILLIM
DHE BASHKËPUNIM, PËR PROGRAMIN E ZHVILLIMIT RAJONAL
PËR SHQIPËRINË, RATIFIKUAR ME LIGJIN NR. 66/2017”**

Në mbështetje të neneve 78, pika 1, dhe 83, pika 2, të Kushtetutës, si dhe të neneve 28 dhe 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

I. Të shqyrtojë me procedurë të përshpejtuar projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes për bashkëpunimin teknik ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Zhvillimit Urban, dhe Qeverisë së Konfederatës Zvicerane, të përfaqësuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, për programin e zhvillimit rajonal për Shqipërinë, ratifikuar me ligjin nr. 66/2017”.

II. Shqyrtimi në Komisionin përgjegjës për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin të bëhet në datën 28.2.2019.

III. Komisione për dhënie mendimi janë: Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut dhe Komisioni për Politikën e Jashtme.

IV. Shqyrtimi në seancë plenare të bëhet në datën 5.3.2019.

V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I

Gramoz RUÇI

Miratuar në datën 26.2.2019